

Intervista e Ministrit Avdullah Hoti për Gazetën “Epokën e re”

Ekonomia po vihet në binarë të zhvillimit

- E ftoj opozitën të jetë konstruktive me kritika dhe sugjerime për politikat qeverisëse në interes të qytetarëve

- Projekti i Brezovices pritet t’i japë impuls të ri zhvillimit të turizmit në Kosovë

Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria Mustafa është duke punuar me dinamikën e duhur për t’i zbatuar premtimet e dhëna për këta katër vjet të qeverisjes. Ai thotë se ky koalicion (PDK - LDK) e ka filluar qeverisjen me mandat të qartë dhe program të detajuar. Hoti ka treguar se janë duke punuar në strategjinë kombëtare të zhvillimit, e cila, sipas tij, do të jetë shumë më konkrete sa iu përket masave dhe aktiviteteve që do të ndërmerren për t’i realizuar objektivat qeverisëse. Sipas tij, politikat fiskale që ka ndërmarrë Qeveria gjatë këtij viti do të japin efekte në investime dhe në punësim. Hoti ka theksuar se nënshkrimi i marrëveshjeve për kredi me institucionet financiare do të hapë mundësi për një zhvillim më të shpejtë ekonomik të Kosovës, rritje të shpejtë të punësimit dhe integrim në tregje rajonale dhe evropiane

Afet Bela

Prishtinë, 13 shtator - Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria Mustafa është në rrugë të mirë për t’i vendosur parakushtet për zhvillim më të madh ekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë intervistë për “Epokën e re”, Hoti ka bërë me dije se gjatë këtij viti ka pasur zhvillime pozitive sa i përket zhvillimit të ekonomisë në vend. Ai ka thënë se politikat fiskale që ka ndërmarrë Qeveria gjatë këtij viti do të japin efekte në investime dhe, rrjedhimisht, në punësim dhe në të ardhura në vitet që vijnë.

Hoti ka thënë se është herët të flitet për arritjet e kësaj Qeverie në sektorin e ekonomisë, megjithatë ai ka treguar se janë bërë hapa konkretë për të siguruar rezultate më të mira në ekonomi, punësim, konkurrencë të bizneseve vendore, rritje të prodhimit vendor dhe në aspekte të tjera.

Ministri Hoti thotë se nuk është kënaqur me dinamikën e disa ndryshimeve që duhet të bëhen. “Ka burokraci të brendshme në institucione qeveritare që duhet të eliminohet. Ka diskrecion të zyrtarëve qeveritarë në institucione të ndryshme që, gjithashtu, duhet të rregullohet me ligje përkatëse. Na duhen indikatorë të performancës për institucionet kyçe qeveritare, për disa ndërmarrje publike dhe agjenci të pavarura, pasi nga efikasiteti i punës së tyre varet performanca e Qeverisë në disa aspekte, sidomos sa i përket tërheqjes së investimeve të jashtme, promovimit të prodhimit vendor dhe uljes së kostos së shërbimeve publike që ofrohen nga ndërmarrjet publike”, ka deklaruar ai.

Hoti ka shtuar se me këtë Qeveri është krijuar një frymë e re sa i përket të bërit biznes dhe ka bërë me dije se viti 2016 do t’i japë rezultatet e politikave që kanë ndërmarrë gjatë këtij viti. “Ne kemi zhvilluar disa skenarë të zhvillimit ekonomik për 2016-n, varësisht nga dinamika e disa projekteve që pritet të fillojnë. Projekti i Brezovicës pritet t’i japë impuls të ri zhvillimit të turizmit në Kosovë. Varësisht nga progresi që bëhet në projektin ‘Kosova re’ mund të kemi efekte pozitive për vite me radhë në investime dhe punësim. Ka edhe disa projekte të tjera që janë në zhvillim e sipër e që sigurojnë rritje të qëndrueshme për 2016-n dhe vitet në vijim”, është shprehur Hoti.

Ministri i Financave ka theksuar se nënshkrimi i marrëveshjes për kredinë më të madhe deri më tani me BERZH-in, në vlerë prej 39.9 milionë eurosh dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për kredi me institucionet e tjera financiare do të hapin mundësi për një zhvillim më të shpejtë ekonomik të Kosovës, rritje të shpejtë të punësimit dhe integrim në tregje rajonale dhe evropiane. Hoti ka folur edhe pakon e re fiskale, e cila ka hyrë në fuqi nga 1 shtatori. Sipas tij, kjo pako po pranohet gjerësisht nga bizneset dhe nga odat ekonomike si një reformë që do të prodhojë efekte pozitive si për qytetarët me të ardhura mesatare dhe të ulëta, ashtu edhe për promovimin e investimeve. Duke folur për kritikën e opozitës në adresë të Qeverisë sa i përket zhvillimit ekonomik, Hoti ka thënë se është i hapur për t'i pranuar sugjerimet e opozitës. “Do të vazhdoj t'i dëgjoj me vëmendje sugjerimet dhe kritikën e tyre edhe në politikën e reja që jemi duke i zhvilluar në fushën e të bërit biznes. E ftoj opozitën të jetë konstruktive me kritikën dhe sugjerimet për politikën qeverisëse në interes të qytetarëve”, ka deklaruar ai. Hoti ka thënë se qeveria Mustafa është duke punuar me dinamikën e duhur për t'i zbatuar premtimet e dhëna për këta katër vjet të qeverisjes. “E kemi filluar qeverisjen me mandat të qartë dhe program të detajuar, që është diskutuar në Kuvendin e Kosovës. Tani po punojmë në strategjinë kombëtare të zhvillimit, e cila do të jetë shumë më konkrete sa iu përket masave dhe aktivitetëve konkretë që do të ndërmerren për t'i realizuar objektivat qeverisëse”, ka thënë Hoti.

“Epoka e re”: *Ministër, si e vlerësoni gjendjen aktuale ekonomike në vend?*

Hoti: Ka zhvillime pozitive gjatë këtij viti, që jep shpresë se rritja ekonomike do të jetë brenda normës së pritshme të zhvillimit. Sigurisht se nuk mjafton kjo rritje që e kemi për ta absorbuar numrin e madh të të papunëve në Kosovë dhe numrin e madh të atyre që diplomojnë çdo ditë nga universitetet.

“Epoka e re”: *Sa ka arritur qeveria Mustafa ta qesë në binarë të zhvillimit ekonominë e vendit?*

Hoti: Mendoj se jemi në rrugë të mirë për t'i vendosur parakushtet për zhvillim më të madh ekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm. Politikën fiskale që kemi ndërmarrë gjatë këtij viti besoj shumë se do të japin efekte në investime dhe, rrjedhimisht, në punësim dhe në të ardhura në vitet që vijnë. Po punohet edhe në drejtime të tjera, siç është thjeshtësimi i procedurave për të bërë biznes, duke unifikuar lejet dhe licencat në një ligj të vetëm, duke unifikuar numrin e TVSH-së me numrin e biznesit, duke thjeshtëzuar procedurat e eksportit dhe importit. Gjithashtu, po punojmë edhe në ndryshime të tjera.

“Epoka e re”: *A jeni të kënaqur me arritjet që i ka pasur qeveria e re?*

Hoti: Sigurisht se është herët të flasim për arritje, por mund të flasim për hapat konkretë që janë ndërmarrë për të siguruar rezultate më të mira në ekonomi, punësim, konkurrencë të bizneseve vendore, rritje të prodhimit vendor dhe në aspekte të tjera. Nuk jam i kënaqur me dinamikën e disa ndryshimeve që duhet të bëhen. Ka burokraci të brendshme në institucione qeveritare që duhet të eliminohet. Ka diskrecion të zyrtarëve qeveritarë në institucione të ndryshme që, gjithashtu, duhet të rregullohet me ligje përkatëse. Na duhen indikatorë të performancës për institucionet kyçe qeveritare, për disa ndërmarrje publike dhe agjenci të pavarura, pasi nga efikasiteti i punës së tyre varet performanca e Qeverisë në disa aspekte, sidomos sa i përket tërheqjes së investimeve të jashtme, promovimit të prodhimit vendor dhe uljes së kostos së shërbimeve publike që ofrohen nga ndërmarrjet publike.

“Epoka e re”: *Sa pritni të jetë rritja ekonomike deri në fund të këtij viti dhe në këtë kontekst çfarë prisni në vitin 2016?*

Hoti: Po presim t’i kemi vlerësimet e para për zhvillimet gjatë këtij viti. Pritjet janë pozitive, pasi janë krijuar parakushtet dhe është krijuar një frymë e re sa i përket të bërit biznes. Viti 2016 do t’i japë rezultatet e politikave që kemi ndërmarrë gjatë këtij viti. Ne kemi zhvilluar disa skenarë të zhvillimit ekonomik për 2016-n, varësisht nga dinamika e disa projekteve që pritet të fillojnë. Projekti i Brezovicës pritet t’i japë impuls të ri zhvillimit të turizmit në Kosovë. Varësisht nga progresi që bëhet në projektin ‘Kosova re’ mund të kemi efekte pozitive për vite me radhë në investime dhe punësim. Ka edhe disa projekte të tjera që janë në zhvillim e sipër që sigurojnë rritje të qëndrueshme për 2016-n dhe vitet në vijim.

“Epoka e re”: *Kosova ka nënshkruar marrëveshje me FMN-në. Do të shikoni që sërish të hyni në kredi për faktin se në vitet e ardhshme Kosova duhet të ndërtojë infrastrukturë të re?*

Hoti: Marrëveshja me FMN-në hap kapitull të ri të zhvillimit ekonomik për Kosovën. Klauzola e investimeve që është pjesë e programit dhe që pritet të miratohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës krijon mundësinë të hyjmë në kredi ndërkombëtare për të financuar projekte zhvillimore. Një nga këto projekte është edhe kredia me BERZH-in që e kemi nënshkruar më 4 shtator në Londër. Nuk do të hyjmë në kredi vetëm për projekte infrastrukturore, por edhe për projekte të tjera në bujqësi, arsim e shëndetësi.

“Epoka e re”: *Sa është e leverdishme kredia me BERZH-in, e cila është marrë për rikonstruktimin e hekurudhës?*

Hoti: Kosova ka nënshkruar kredinë më të madhe deri më tani me BERZH-in, në vlerë prej 39.9 milionë eurosh, për rehabilitimin e hekurudhës nga kufiri me Maqedoninë në Hanin e Elezit deri në Leshak në kufi me Serbinë, në gjatësi prej 148 km, me kosto totale prej 195.5 milionë eurosh. Pas disa muajsh nënshkruhet edhe kredia me Bankën Evropiane për Investime në vlerë prej 41.4 milionë eurosh. Po ashtu, Komisioni Evropian do ta mbështesë këtë projekt me 79.8 milionë euro grant, si dhe grante prej 1.1 milion eurosh nga BERZH-i dhe 5.5 milionë euro nga WBIF. Pjesa tjetër është kontribut i Qeverisë së Kosovës. Kredia është me kushte shumë të volitshme prej 1 % normë interesi, plus mesatarja gjashtëmujore e Euriborit, me katër vjet grejs periudhë dhe 11 vjet afat të kthimit të kredisë, që është lehtësisht e përballeshme për buxhetin e Kosovës. Kjo kredi dhe të tjerat për projektet e ardhshme do të hapin mundësi për një zhvillim më të shpejtë ekonomik të Kosovës, rritje të shpejtë të punësimit dhe integrim në tregje rajonale dhe evropiane. Tani është e nevojshme ngritja e kapaciteteve menaxheriale dhe teknike të Kompanisë Publike “Infrakos” për të implementuar me sukses projektin dhe për të kontribuar në kthimin e kredisë nëpërmjet gjenerimit të të hyrave.

“Epoka e re”: *Çfarë do të mund të përfitojë Kosova nga planet rajonale, konkretisht nga Samiti i Berlinit dhe i Vjenës?*

Hoti: Fondet e Bashkimit Evropian për ta mbështetur zhvillimin e Ballkanit Perëndimor dhe integrimin e këtij rajoni në Bashkimin Evropian janë një mundësi e mirë për Kosovën për të investuar në projekte të karakterit rajonal, të cilat e fuqizojnë pozitën e Kosovës dhe e integrojnë ekonominë e vendit tonë më mirë në tregjet rajonale dhe më gjerë. Kjo është një mundësi që nuk duhet humbur. Unë pres që ministrinë e linjës të jenë të gatshme me projekte konkrete për të konkurruar për financim.

“Epoka e re”: *Së fundi ka hyrë në fuqi pakoja e re fiskale. Çfarë prisni nga kjo pako?*

Hoti: Pakoja e re fiskale, që ka hyrë në fuqi nga 1 shtatori, po pranohet gjerësisht nga bizneset dhe nga odat ekonomike si një reformë që do të prodhojë efekte pozitive, si për qytetarët me të ardhura mesatare dhe të ulëta, ashtu edhe për promovimin e investimeve. Përgjysmimi i TVSH-së për produktet dhe shërbimet esenciale, siç specifikohen në Ligjin e TVSH-së, pastaj heqja e plotë e TVSH-së për import të të gjitha makinerive prodhuese, lëndëve të para që përdoren për prodhim dhe për teknologjinë informatike, lirimet tatimore për investime të reja që do të zhvillohen së shpejti, janë vetëm disa nga ndryshimet kryesore. Dëshiroj t’i falënderoj bizneset dhe odat ekonomike për rolin e tyre në zhvillimin e kësaj pakoje fiskale dhe për mbështetjen e dhënë për ta qartësuar atë për komunitetin e biznesit. Në javët në vijim do të jem në terren për të vizituar biznese të ndryshme, zyrat regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës dhe disa pika të Doganave të Kosovës për të parë se si po implementohet pakoja fiskale. Me këtë rast, do t’i identifikojmë nevojat ku duhet të intervenohet më tutje nëpërmjet udhëzimeve administrative dhe vendimeve të tjera për ta lehtësuar implementimin e plotë të pakos fiskale. I ftoj bizneset të raportojnë çfarëdo paqartësie që mund të kenë lidhur me këtë pako.

“Epoka e re”: *Kush përfiton më shumë nga kjo pako, qytetarët apo bizneset?*

Hoti: Përfitimet më të mëdha janë për qytetarët me të ardhura të ulëta dhe për bizneset që bëjnë investime dhe ato biznese që janë prodhuese. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet përgjysmimit të normës së TVSH-së në 8 % për produktet bazike. Po ashtu, heqja e TVSH-së nga importi i makinerisë prodhuese, nga lëndët e para dhe nga pajisjet e teknologjisë informatike promovon investimet dhe prodhimin vendor. Kjo sigurisht do të japë rezultate në rritjen e prodhimit vendor dhe uljen e importeve në vitet në vijim.

“Epoka e re”: *Opozita ka kritikuar për planet e Qeverisë dhe premtimet që i keni bërë si koalicion qeverisës?*

Hoti: Unë kam qenë shumë i hapur për t’i pranuar sugjerimet e opozitës gjatë zhvillimit të ligjeve të pakos fiskale. Do të vazhdoj t’i dëgjoj me vëmendje sugjerimet dhe kritikën e tyre edhe në politikën e reja që jemi duke i zhvilluar në fushën e të bërit biznes. E ftoj opozitën të jetë konstruktive me kritikën dhe sugjerimet për politikën qeverisëse në interes të qytetarëve.

“Epoka e re”: *A do të arrini ta realizoni një pjesë të premtimeve që i keni dhënë si koalicion qeverisës?*

Hoti: Mendoj se jemi duke punuar me dinamikën e duhur për t’i zbatuar premtimet e dhëna për këta katër vjet të qeverisjes. E kemi filluar qeverisjen me mandat të qartë dhe program të detajuar, që është diskutuar në Kuvendin e Kosovës. Tani po punojmë në strategjinë kombëtare të zhvillimit, e cila do të jetë shumë më konkrete sa iu përket masave dhe aktiviteteve konkrete që do të ndërmerren për t’i realizuar objektivat qeverisëse.